



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly



NATIONAL
DEMOCRATIC
INSTITUTE

**Memorandum bashkëpunimi
ndërmjet
Institutit Kombëtar Demokratik (NDI)
dhe
Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës**

**Neni 1
Qëllimi**

Memorandumi i Bashkëpunimit ka për qëllim përcaktimin e bashkëpunimit ndërmjet Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) për realizimin e Programit të Trajnimit Profesional për Vizualizim të të Dhënave dhe Menaxhim të Mediave Sociale, i cili u dedikohet zyrtarëve të Administratës së Kuvendit.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Duke qenë se po jetojmë në epokën e dixhitalizimit, ku platformat sociale janë një burim primar informacioni për shumë njerëz, edhe parlamentet kanë filluar të adaptojnë dhe dizajnojnë informata sa më lehtë të lexueshme për lexuesin, duke përfshirë kështu përdorimin e infografikave, posterave e videove informative. Këto, përpos që janë atraktive, ato ju ofrojnë publikut mundësi të marrin të gjitha të dhënat, statistikën dhe mesazhin brenda një kohe të shkurtër, pa pasur nevojë të shfletojnë sasi të mëdha informacioni. Për më tej kjo formë e komunikimit kontribuon drejtpërdrejt në avancimin e transparencës parlamentare, e si rrjedhojë rrit besueshmërinë e qytetarëve në institucionet e vendit. Në këtë drejtim, për t'ju përgjigjur kërkesave dhe nevojave për rritjen e njohurive dhe shkathtësive të stafit profesional të administratës së Kuvendit, NDI ka dizajnuar një program profesional të trajnimit, për të cilin ka angazhuar kompaninë vendore "Qendra Kosovare e Inovacionit" (ICK) për të ofruar trajnim profesional për zyrtarët e administratës së Kuvendit të Kosovës, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në dizajnimin e Infografikave, vizualizimin e të dhënave, shkathtësive dixhitale dhe editimin e videove.

Neni 3

Modulet e programit të trajnimit

1. Programi i trajnimit profesional përfshinë dy module:
 - 1.1. Dizajnim të Infografikave dhe
 - 1.2. Aftësi Dixhitale.
2. Kohëzgjatja e programit është 50 orë, 25 orë për secilin modul, 2 herë në javë nga 3 orë.
3. Moduli i parë fillon me 21 qershor 2021 dhe përfundon me 21 korrik 2021.
4. Moduli i dytë fillon me 1 shtator 2021 dhe përfundon me 30 shtator 2021.
5. Pjesëmarrës në trajnim janë: Zyrtarë nga Drejtoria për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv (DHBA), Drejtoria për Marrëdhënie me Publikun dhe Media, si dhe Drejtoria për Mbështetjen e Komisioneve Parlamentare.

Neni 4

Obligimet për palët në memorandum të bashkëpunimit

1. Obligimet e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI), janë si në vijim:
 - 1.1. Finalizimi i programit të trajnimit në përputhje me nevojat dhe kërkesat e Kuvendit;
 - 1.2. Finalizimi i marrëveshjes me kompaninë ICK për zhvillimin e programit të trajnimit;
 - 1.3. Mbikëqyrja e mbarëvajtjes së trajnimit, cilësisë së ofruar dhe pjesëmarrjes së zyrtarëve;
 - 1.4. Pjesëmarrësit certifikohen nga ICK, ndërsa ceremonia e certifikimit organizohet nga NDI dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit;
 - 1.5. Monitorimi i rezultateve të trajnimit, nëse zyrtarët përfitues të trajnimit do t'i përdorin aftësitë e fituara nga trajnimi.
2. Obligimet e Kuvendit, janë si në vijim:
 - 2.1. Sigurimi i pjesëmarrjes së zyrtarëve në trajnim;
 - 2.2. Në rast të mungesës së paarsyetuar në trajnim dhe neglizhencës në pjesëmarrje nga zyrtari, Kuvendi obligohet t'i mbuloj shpenzimet e programit për atë zyrtar;
 - 2.3. Kuvendi sigurohet që zyrtarët t'i përdorin aftësitë e marra në trajnim për punët e përditshme të Kuvendit;
 - 2.4. Kuvendi, pas përfundimit të programit, do të siguroj qasje në softverët e duhur (programe ose aplikacione online ose me abonim) që ju mundëson zyrtarëve që kanë ndjekur programin të zbatojnë njohuritë e tyre në dobi të Kuvendit.

Neni 5

Certifikimi

Në fund të Programit, NDI në bashkëpunim me Kuvendin dhe ICK certifikon pjesëmarrësit për përfundimin e suksesshëm të programit dhe arritjet profesionale. Në varësi të rrethanave me pandeminë COVID19, organizohet ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve.

Neni 6
Shtojcat

Shtojcat e memorandumit të bashkëpunimit janë:

1. Lista e zyrtarëve që do ta ndjekin programin e trajnimit;
2. Orari i programit të trajnimit (i cili do të finalizohet në koordinim me pjesëmarrësit).

Neni 7
Hyrja në fuqi

Ky memorandum bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.

Për Administratën e Kuvendit
të Republikës së Kosovës

Ismet Krasniqi

Sekretar i Përgjithshëm
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Për Institutin Kombëtar Demokratik (NDI)

Valon Kurhāsani

Zv. Drejtör i NDI për Kosovë
Institut Kombëtar Demokratik (NDI)

Prishtinë, 15 qershor 2021